


Të drejtat për gjykim të drejtë dhe gjendjet e jashtëzakonshme në shëndetin publik



Rekomandimet në këtë përmbledhje të politikave janë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të ODIHR-it për t'iu përgjigjur sfidave që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të shkaktuara nga pandemia COVID-19 në kuadër të OSBE-së.

Ky dokument së pari është botuar nga ana e Zyrës për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së në gjuhën angleze në vitin 2021 si "Fair Trial Rights and Public Health Emergencies". Versioni në gjuhën shqipe është përkthim jo zyrtar, i përgatitur dhe i botuar nga Misionit të OSBE-së në Shkup. Mendimet dhe informatat nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe pozitën e ODHR. Për çdo paqartësi ju lutem shihni versionin origjinal në gjuhën angleze.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
FJALOR	6
1. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME	7
2. ORGANIZIMI I GJYQËSISË NACIONALE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.....	8
3. RREGULLA TË PROCEDIMIT TË RASTEVE TË REJA GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK	11
4. TEKNOLOGJI TË REJA TË KOMUNIKIMIT.....	12
5. VEPRAT PENALE LIDHUR ME GJENDJET E JASHTËZAKONSHME DHE DËNIMET GJATË GJENDJEVE NË SHËNDETIN PUBLIK.....	14
6. PROCESI I PARABURGIMIT NË PROCEDURA PARA HETIMORE DHE PARABURGIMIT NË PRITJE TË GJYKIMIT SIPAS KËRKESËS	16
7. MONITORIMI I GJYKIMIT DHE SEANCAVE DËGJIMORE PUBLIKE.....	17
ANEKSI: LISTA E BURIMEVE.....	18

HYRJE

Shtetet pjesëmarrëse të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) zotohen të krijojnë dhe të ruajnë një sistem efektiv gjyqësor, të sigurojnë respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë, si dhe të të drejtave tjera të rëndësishme të njeriut. Sistemi gjyqësor është kyç për funksionimin e drejtë të çdo shteti. Gjykatat e pavarura mund të sigurojnë që degët tjera të pushtetit të garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Pandemia e COVID-19 krijoi sfida të konsiderueshme në funksionimin e sistemit gjyqësor dhe e drejta për gjykim të drejtë ka qenë nën presion të madh gjithandej rajonit të OSBE-së për shkak të masave të ndryshme kufizuese të vendosura gjatë pandemisë

Këto rekomandime politikash ofrojnë udhëzime për politikëbërës, përfaqësuesit e gjyqësorit, profesionistët ligjorë, shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuarase si të zhvillojnë, të zbatojnë dhe të ndjekin legjislacionin dhe rregullat në pajtim me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të drejtat tjera relevante gjatë situatave të jashtëzakonshme të shëndetit publik, duke u kujdesur për barazinë dhe diversitetin.

Aspektet e ndryshme të të drejtës për gjykim të drejtë janë në fokus të punës së Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). ODIHR mbështet shtetet pjesëmarrëse në përpjekjet e tyre që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Duke i propozuar këto rekomandime për politika, ODIHR vazhdon me përpjekjet për të ndihmuar autoritetet në tejkalimin e sfidave të papara të shkaktuara nga pandemia COVID-19.

Një pandemi si COVID-19 është gjendje e jashtëzakonshme në shëndetin publik dhe në këtë drejtim shkojnë edhe këto rekomandime. Ato mund të jenë më pak të rëndësishme në llojet e tjera të gjendjeve të jashtëzakonshme, siç janë gjendjet e jashtëzakonshme ushtarake apo fatkeqësitë natyrore. Gjendjet e jashtëzakonshme në shëndetin publik paraqesin sfida të rëndësishme dhe specifike për funksionimin normal të gjyqësorit, por është thelbësore që të ruhet funksionimi i gjykatave gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme të tilla për aq sa është e sigurt dhe e mundshme. Për të parandaluar

përhapjen e sëmundjes, shtetet mund të jenë të detyruara të miratojnë rregulla dhe rregullore për gjendje të jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me funksionimin e gjyqësorit.

Këto rregulla dhe rregullore emergjente në thelb nuk duhet të pengojnë zbatimin e drejtësisë në mënyrë që të përputhet me të drejtat e njeriut.

Këto rekomandime politikash frymëzohen nga standardet ndërkombëtare që lidhen me funksionimin e gjyqësorit gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik, standardet përkatëse të të drejtave të njeriut të përpiluara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe institucionet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe praktikrat e mira të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Këto rekomandime nuk duhet të përdoren për të justifikuar kufizimin e të drejtave. Në fakt, mund të inkorporohen edhe standarde nacionale të cilat do të jenë më të gjëra se ato që janë përcaktuar këtu, që garantojnë funksionimin efektiv të gjyqësorit gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik, nëse shtetet i konsiderojnë të përshtatshme dhe të mundshme.

Kjo përmbledhje zgjerohet mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore të përshkruara në dy raportet e ODIHR-it të botuara në vitin 2020: [Angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor dhe Reagimet e shtetit ndaj pandemisë COVID-19](#) dhe [Funksionimi i Gjykatave gjatë Pandemisë COVID-19 : Udhëzuesi bazë](#).

Gjatë gjithë kohës së pandemisë së COVID-19, ODIHR realizoi diskutime me palë të ndryshme të interesuara, duke përfshirë gjykatësit, shoqërinë civile, organizatat partnere ndërkombëtare dhe rajonale dhe misionet rajonale të OSBE-së për identifikimin e sfidave kryesore të pandemisë me të cilat përballen gjyqësorët anëmbanë rajonit të OSBE-së, në veçanti për shkak të gjykimeve që bëhen përmes internetit, si dhe për identifikimin e zgjidhjeve që do të sigurojnë respektimin e të drejtës për gjykim të drejtë. Në përgjithësi, ODIHR u konsultua me rreth 50 ekspertë nga të gjitha nën rajonet gjeografike të OSBE-së në procesin e zhvillimit të këtij raporti për politikat. Në fazën

përfundimtare të zhvillimit, katër ekspertë me përvojë në të drejtën e gjyqimit të drejtë, duke përfshirë gjyqtarë të lartë, ndërmorën një rishikim të detajuar të përmbledhjes së politikave që të vlerësojnë se si rekomandimet e d u përgjigjen nevojave të profesionistëve ligjorë dhe të vërtetoj përputhjen e tij me standardet dhe praktikat e mira të njohura ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut.

FJALOR

Seanca hibride – një seancë gjyqësore që zhvillohet pjesërisht online, gjegjësisht disa pjesëmarrës janë me prezencë fizike (për shembull, gjykatës, disa dëshmitarë dhe të tjerë) dhe disa janë të lidhur nëpërmjet internetit.

Organet vetëqeverisëse gjyqësore – organet qeverisëse të krijuara në kuadër të gjyqësorit nacional që të garantojnë efektivitetin e sistemit gjyqësor dhe të lehtësojnë zbatimin e rregullave dhe rregulloreve të përgjithshme. Ky përkufizim përfshin këshilla të ndryshëm gjyqësor, kryetarë gjykatash në nivele të ndryshme dhe administratë gjyqësore..

Gjyqësori nacional – të gjitha gjykatat dhe trupat gjykues që ekzistojnë në një vend të caktuar.

Seanca online – një seancë gjyqësore që zhvillohet plotësisht online, gjegjësisht, të gjithë pjesëmarrësit janë në vende të ndryshme dhe janë të lidhur nëpërmjet internetit.

Pjesëmarrësit profesionistë të gjykatës – gjykatës, stafi i gjykatës, avokatët mbrojtës dhe prokurorët.

Gjendje e jashtëzakonshme në shëndetin publik – një situatë e pazakontë kërcënuese për jetën që paraqet një rrezik të konsiderueshëm për një numërtë konsiderueshëm vdekjesh njerëzore ose paaftësi të përhershme ose afatgjatë, në përputhje me përkufizimin tepër gjendjet e jashtëzakonshme në shëndetin publik të **Organizatës Botërore të Shëndetësisë**.

Hartuesit e rregullave – për qëllimet e këtyre rekomandimeve, organet shtetërore (përfshirë organet vetëqeverisëse gjyqësore) me kompetencë për të vendosur rregulla dhe rregullore, përfshirë ato që synojnë parandalimin e përhapjes së sëmundjes gjatë emergjencës së shëndetit publik. Këto organe shtetërore përfshijnë organet përkatëse legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

Palë të interesuara – për qëllimet e këtyre rekomandimeve, palët e interesuara janë gjykatësit, personeli ndihmës në gjyqësor, prokurorët, avokatët mbrojtës, palët, të pandehurit, viktimat, dëshmitarët, punonjësit socialë përkatës, ekspertët dhe pjesëmarrësit e tjerë në gjykim.

1. REKOMANDIME TËPËRGJITHSHME

1.1. RREGULLATKOMBËTARE TË ZHVILLUARA NË PËRGJIGJE TË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK DUHET TË MIRATOHEN NË PËRPTHJE ME PROCEDURAT EKZISTUESE NACIONALE. KËTO RREGULLA DUHET TË INTERPRETOHEN NË MËNYRË RESTRIKTIVE DHE TË JENË PROPORCIONALE ME SYNIMIN E CAKTUAR.

Një gjendje e jashtëzakonshme formale duhet të shpallet nëse ligji i një shteti pjesëmarrës parashikon një deklaratë të tillë dhe nëse rregullat e miratuara të emergjencës vendosin kufizime të rëndësishme në jetën publike dhe ndikojnë në funksionimin normal të një gjyqësori nacional. Një parakusht i domosdoshëm për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të jetë që kompetencat e parashikuara nga legjislacioni i rregullt mos të jenë të mjaftueshme për tejkalimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Prandaj, qëllimi përfundimtar i çdo gjendje të jashtëzakonshme duhet të jetë që shteti të zgjidhë situatën e jashtëzakonshme dhe të kthehet në gjendjen e normalitetit sa më shpejt të jetë e mundur.

Pa marrë parasysh a është shpallur zyrtarisht një gjendje e jashtëzakonshme, rregullat e miratuara në përgjigje të një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik duhet të jenë të qarta dhe të qëndrueshme dhe ato duhet të miratohen në përputhje me procedurat që tashmë ekzistojnë. Ato duhet të përfshijnë një afat kohor ose tregues të qartë se kur do të pushojnë së ekzistuari këto rregulla për raste urgjente. Ato duhet të rishikohen periodikisht dhe nuk duhet të kenë kohëzgjatje të pacaktuar. Rregullat për gjendje të jashtëzakonshme duhet të jenë relevante dhe të nevojshme për të reduktuar pasojat negative të gjendjes së jashtëzakonshme në shëndetin publik. Rregullat duhet të synojnë të zbusin pabarazinë gjinore të përkeqësuar nga gjendja e jashtëzakonshme në shëndetin publik, për shembull qasja e kufizuar në kujdesin ndaj fëmijëve. Gjithashtu është e rëndësishme të sigurohet që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të mos preken në mënyrë jo proporcionale nga rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme.

Ndikimi i rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme në gjyqësorin nacional dhe palët tjera të interesuara duhet të merret parasysh përpara miratimit të tyre. Këto rekomandime marrin parasysh vetëm rregullat gjendjes së jashtëzakonshme të rëndësishme për gjyqësorin nacional; për një analizë më gjithëpërfshirëse të rregullave dhe rregulloreve të emergjencës, shih [Angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor dhe përgjigjet e shtetit ndaj pandemisë COVID-19](#).

1.2. AUTORITETET DUHET TË SIGUROJNË QË GJYQËSIA NACIONALE TË VAZHDOJË TË FUNKSIONOJË ME KAPACITETIN MË TË PLOTË TË MUNDSHËM GJATË NJË GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Gjykatësit, stafi i gjykatës, avokatët mbrojtës dhe prokurorët duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë punën e tyre, megjithëse me disa kufizime dhe restriksione të nevojshme. Për shembull, ata duhet të përfshihen në listën e profesioneve të liruar nga ora policore, kufizimet e udhëtimit dhe kufizime të tjera të ngjashme që ndikojnë në aftësinë e tyre për të përmbushur funksionet e tyre, nëse vendosen kufizime të tilla. Duhet të vendoset një sistem që lejon ekspertët, punonjësit socialë dhe pjesëmarrësit e tjerë kyç të gjykimeve urgjente të udhëtojnë në gjykata. Rregullat për gjendje të jashtëzakonshme nuk duhet të cenojnë kërkesat themelore të të drejtave të gjykitimit të drejtë, të tilla si qasja në gjykatë dhe mjetet efektive juridike, barazia mes palëve, besueshmëria e komunikimit ndërmjet palëve dhe avokatëve të tyre, prezumimi i pafajësisë dhe shumë të tjera. Hartuesit e rregullave mund të marrin në konsideratë përfshirjen e pjesëmarrësve profesionistë të gjykatave në kategoritë me përparësi për marrjen e vaksinave dhe pajisjeve mbrojtëse personale. Rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të jenë me ndjeshmëri gjinore. Për shembull, pjesëmarrësit e gjykatave profesionale duhet të kenë të drejtën e qasjes me prioritet në kujdesin ndaj fëmijëve dhe përfitimet përkatëse sociale në aspekt të respektimit të gjinisë dhe diversitetit. Për një diskutim më të detajuar lidhur me funksionimin e gjyqësorit gjatë pandemisë COVID-19, shih [Funksionimi i gjykatave gjatë pandemisë COVID-19: Udhëzues bazë](#).

2. ORGANIZIMI I GJYQËSISË NACIONALE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK

2.1. ORGANET VETËQEVERISËSE TË GJYQËSORIT DUHET TË MIRATOJNË RREGULLA ADEKUATE, TË QARTA DHE TË PARASHIKUESHME LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E GJYQËSISË NACIONALE.

Organet vetëqeverisëse gjyqësore duhet të miratojnë metoda dhe qasje të reja adekuate të punës për procesin e dhënies së drejtësisë gjatë një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Këto metoda të reja duhet të jenë të qarta dhe të parashikueshme, duke lejuar njëkohësisht fleksibilitetin e nevojshëm. Në kuadër të kompetencave të tyre, organet vetëqeverisëse gjyqësore duhet të nxjerrin në mënyrë pro aktive rregulla dhe protokolle që të sigurojnë funksionimin e gjyqësorit nacional në mënyrë sa më efektive dhe më të sigurt. Këto rregulla duhet të përfshijnë normat për rotacionin e gjykatësve dhe personelit ndihmës, orarin e punës, dhënia e prioritetit lëndë, caktimin dhe shtyrjen e seancave, masat shëndetësore gjatë seancave (për shembull distancën), komunikimin me pjesëmarrësit në gjyq dhe publikun, si dhe qasjen në ndërtesat e gjykatës. Rregullat duhet gjithashtu të identifikojnë ata që janë përgjegjës për pajtueshmërinë me këto rekomandime. Këto rregulla duhet të vendosen duke marrë parasysh gjininë dhe diversitetin.

2.2. MENDIMET E PALËVE TË INTERESUARA DUHET TË MERRN PARASYSH GJATË ZHVILLIMIT TË RREGULLAVE TË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME.

Pikëpamjet e arsyeshme të gjykatësve, avokatëve, shërbimeve sociale, prokurorëve dhe shoqërisë civile duhet të merren parasysh në procesin e zhvillimit të rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me gjyqësorin. Rekomandohet që hartuesit e rregullave duhet të krijojnë një komitet konsultativ që do të përfshihej në diskutimin dhe rishikimin e rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme. Komiteti duhet të përbëhet nga palët përkatëse të interesit duke përfshirë gjykatësit. Pa cenuar pavarësinë e organeve vetëqeverisëse gjyqësore, ky komitet duhet të ketë mandat për të dhënë komente dhe

rekomandime për rregullat dhe rregulloret për gjendjet e jashtëzakonshme. Rregullat duhet të rishikohen rregullisht, duke marrë parasysh komentet nga ky komitet.

2.3. RREGULLAT E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME DUHET TË PËRPUTHEN ME LIGJIN DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT ENJERIUT.

Të gjitha rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me gjyqësorin duhet të harmonizohen me ligjet nacionale në fuqi dhe standardet ndërkombëtare të drejtave për gjykim të drejtë dhe sundim të ligjit. Hartuesit e rregullave duhet të verifikojnë harmonizimin e rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme me ligjin përkatës ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Shmangiet nga mekanizmat ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut lejohen vetëm për ato masa që janë rreptësisht të nevojshme gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Të drejtat e padiskutueshme, si ndalimi i torturës ose skllavërisë, nuk duhet të shkelen kurrë edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Rregullat për gjendjen e jashtëzakonshme që prekin të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut duhet të bazohen në parimin gjithëpërfshirës të sundimit të së drejtës dhe në parimet e domosdoshmërisë, përshtatshmërisë, barazisë dhe mos diskriminimit, proporcionalitetit, përkohshmërisë, kontrollit efektiv (parlamentar dhe gjyqësor), parashikueshmërisë së legjislacionit për gjendje të jashtëzakonshme dhe bashkëpunimit besnik ndërmjet institucioneve shtetërore.

2.4. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME DUHET TË SIGUROJNË INTERESAT E PJESËMARRËSVE MË TË CENUESHËM NË GJYQ.

Ndikimi i gjendjes së jashtëzakonshme në shëndetin publik mund të jetë veçanërisht i rëndë për grupet më të cenueshme, duke përfshirë njerëzit me aftësi të kufizuara, të moshuarit, pakicat etnike, njerëzit e pastrehë, të miturit, emigrantët dhe të tjerët. Rregullat

për gjendje të jashtëzakonshme nuk duhet të supozojnë një nivel të caktuar të njohurive kompjuterike, arsimimin, aftësisë ose qasjes etj. Rregullat për gjendje të jashtëzakonshme duhet të shpjegojnë se çfarë duhet bërë nëse palët nuk kanë qasje në kompjuterë ose nuk janë në gjendje t'i përdorin ata në rast të seancave dëgjimore online ose hibride. Rregullat duhet të sigurojnë të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë efektive në seancat dëgjimore online ose hibride pa i vënë personat me aftësi të kufizuara dhe individëve të tjerë të cenueshëm në pozitë të jenë të frikësuar ose të jenë nën shtypje.

2.5. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME NUK DUHET TË KUFIZOJNË PADREJTËSISHT QASJEN DERITEK AVOKATIPËR TË DYSHUARIT APO TË AKUZUARIT.

Autoritetet duhet të sigurojnë qasje të menjëhershme të një avokat për të gjithë të dyshuarit ose të akuzuarit, duke përfshirë edhe ata që janë në paraburgim apo burgim. Në rrethana të jashtëzakonshme kur autoritetet policore nuk janë në gjendje të garantojnë qasje me prezencë fizike të një avokat, qasja në distancë mund të organizohet duke iu nënshtuar masave mbrojtëse të caktuara.

2.6. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME DUHET TË SIGUROJNË PËRKTIM PËR ATA QË NUK E KUPTOJNË GJUHËN E GJYQIT.

Kur e drejta e përkthimit supozohet të sigurohet në seancat dëgjimore me prezencë fizike, ajo duhet të sigurohet dhe lehtësohet gjithashtu në seancat dëgjimore online ose hibride, pa pagesë. Gjykatat duhet të përdorin teknologjinë që u lejon atyre të përdorin interpretimin.

2.7. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME DUHET TË LEJOJNË FLEKSIBILITET TË CAKTUAR GJATË ZBATIMIT TË TYRE NË RRETHANA TË DHËNA.

Hartuesit e rregullave duhet të krijojnë një kombinim të rregullave të qëndrueshme dhe të përshtatshme. Hartuesit e rregullave duhet të vendosin një kornizë të qartë, praktike dhe të qëndrueshme, por zbatimi duhet të mbikëqyret nga krerët e gjykatave duke marrë parasysh rrethanat e dhëna. Për shembull, hartuesit e rregullave mund të vendosin një rregull

fiks që duhet të ketë dy metra distancë sociale në çdo gjykatë. Në atë rast, gjykatat duhen të kenë liri në mënyrën si ta zbatojnë këtë rregull (p.sh., ta kufizojnë numrin e pjesëmarrësve, të përdorin seanca dëgjimore hibride ose të shfrytëzojnë hapësira më të mëdha).

2.8. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME DUHET TË LEJOJNË FLEKSIBILITET TË CAKTUAR PËR TË PËRSHTATUR SFIDAT SPECIFIKE ME TË CILAT BALLAFAQOHEN LLOJET E NDRYSHMETË GJYKATAVE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Llojet e ndryshme të gjykatave përballen me sfida të ndryshme dhe rregullat për gjendje të jashtëzakonshme duhet të përshtaten mjaft që të akomodojnë këto dallime. Gjykatat e madhësive të ndryshme (për sa i përket numrit të të punësuarve dhe vendeve në dispozicion) ose juridiksioneve (civile, penale ose për të mitur) kanë nevojë për rregulla të ndryshme të gjendjes së jashtëzakonshme që të mund tu përgjigjen sfidave të gjendjes së jashtëzakonshme në shëndetin publik në mënyrë efektive. Për shembull, gjykatat tregtare mund të mbajnë seanca dëgjimore online ose hibride më lehtë se gjykatat penale për shkak të natyrës së provave që zakonisht prezantohen në seanca të tilla, veçorive të procedurave dhe standardeve të zbatueshme të gjykimit të drejtë.

2.9. HARTUESIT E RREGULLAVE DUHET TË MIRATOJNË PROTOKOLLET QË MBROJNË SHËNDETIN DHE SIGURINË E GJYKATËSVE DHE PALËVETJERATË INTERESUARA.

Rregullat për gjendje të jashtëzakonshme mund të përfshijnë vendosjen e punës në turne për të minimizuar numrin e të të punësuarve në ndërtesa dhe mundësimin e punës nga shtëpia për më të cenueshmit. Turnet nuk duhet të vendosen në mënyrë automatike, por të marrin në konsideratë gjininë dhe diversitetin. Për shembull, turnet nuk duhet t'i ngarkojnë në mënyrë jo proporcionale kujdestarët kryesorë të fëmijëve. Brenda gjykatës duhet të caktohet një person ose një grup njerëzish që mbikëqyrin respektimin e këtyre rregullave.

2.10. HARTUESIT E RREGULLAVE DUHET RREGULLISHT TË MARRIN INFORMACION KTHYES NGA ZBATUESIT E RREGULLAVE.

Hartuesit e rregullave duhet të mbledhin informacione për zbatimin e rregullave gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe përdorimin e teknologjive të reja gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Kjo do të bazë për përmirësimin e cilësisë e reagimit të sistemit gjyqësor ndaj situatës së jashtëzakonshme. Gjykatat vendore duhet të përgatisin raporte që do të përshkruajnë se si do të zbatohen rregullat për gjendje të jashtëzakonshme dhe të njëjtat t'i dërgojnë deri te hartuesit e rregullave.

2.11. GJYKATAT E TË GJITHA NIVELEVE SIDHETË GJITHA PALËT TJERA TË INTERESUARA DUHET TË INFORMOHEN ME KOHË PËRRREGULLATE GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME PËR SIGURIMINE ZBATIMIT UNIFORM TË TYRE.

Metodat efektive të komunikimit ndërmjet hartuesve të rregullave dhe palëve të interesuara janë të një rëndësie kyçe gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Rekomandohet shpërndarja e shpejtë e udhëzimeve që kanë të bëjnë me rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme për të gjithë palët e interesuara. Hartuesit e rregullave mund të përdorin gjithashtu komitetin e sugjeruar në seksionin 2.2 për të ndarë informacionin mes palëve të interesuara. Hartuesit e rregullave duhet gjithashtu të sigurojnë që publiku i gjerë të jetë i informuar për rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme që prekin gjyqësorin nacional përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit të cilave publiku i gjerë lehtë mund t'iu qaset, duke përfshirë faqet e specializuara të internetit si dhe rrjetet sociale dhe profesionale.

2.12. ORGANET E VETËQEVERISJES TË GJYQËSORIT NUK DUHET TË KUFIZOJNË TË DREJTAT DHE MBROJTJET QË NUK KUFIZOHEN DIREKTNGA RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME.

Ato rregullore që nuk preken nga legjislacioni i gjendjes së jashtëzakonshme *de facto* nuk duhet të kufizohen. Gjykatat duhet të ndjekin procedura të rregullta edhe gjatë një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik.

2.13. FINANCIMI BUXHETOR I GJYQËSISË NACIONALE NUK DUHET TË KUFIZOHET GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

E drejta për gjykim të drejtë mund të garantohet siç duhet vetëm nëse gjykatat kanë në dispozicion fondet dhe burimet e duhura. Në kontekstin e gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik, ekziston rreziku që shtetet mund të anashkalojnë rolin e rëndësishëm të gjykatave, që kanë të bëjnë me mjetet juridike efektive kundër masave të jashtëzakonshme dhe ankesave të shkaktuara. Financimi i gjyqësorit nacional, duke përfshirë ndihmën juridike, nuk duhet të kufizohet në mënyrë disproporcionale gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Përkundrazi, financimi duhet të rritet në mënyrë të përshtatshme kur gjyqësorit i kërkohet të zbatojë rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme.

3. RREGULLA TË PROCEDIMIT TË RASTEVE TË REJA GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK

3.1. RREGULLAT E GJENDJES SË JASHTZAKONSHME DUHET TË SIGUROJNË NJË MEKANIZËM PËR TË ZGJATUR AFATET LIGJORE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të rregullojnë se si zbatohen afatet ligjore. Rregullat e tilla duhet të marrin në konsideratë sa është e ndërlikuar situata dhe t'u mundësojnë pjesëmarrësve në gjykim të përdorin plotësisht të drejtat e tyre procedurale duke i lejuar ata të paraqesin dokumente ligjore brenda afateve të përditësuara legjislative. Ndryshimet relevante duhet të përfshihen në legjislacionin e specializuar dhe të zbatohen vetëm në masën që është e nevojshme për të përshtatur rrethanat e veçanta të gjendjes së jashtëzakonshme në shëndetin publik. Rekomandohet të vendoset një rregull i përgjithshëm i zgjatjes së afatit, me mundësinë e përjashtimeve në raste të kufizuara emergjente.

3.2. RREGULLAT E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME DUHET T'JU JAPIN PRIORITET RASTEVE URGJENTE.

Prioriteti dhe kategorizimi i rasteve janë të një rëndësie themelore në rrethanat e një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Kriteret për përcaktimin e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të jenë të qarta dhe të qëndrueshme. Ato mund të përfshijnë nevojën për të parandaluar dëmtimin e pariparueshëm, rastet e lidhura me dhunën në familje, rastet që përfshijnë të mitur ose të moshuar dhe që lidhen me të drejtat e pakufizuara të njeriut siç është ndalimi i torturës. Rastet e të pandehurve të cilët janë të paraburgosur duhet të kenë prioritet. Rregullat e përparësisë duhet të përshtaten mjaft për t'u lënë një hapësirë për liri veprimi gjyqtarëve që të përshtaten në raste të jashtëzakonshme.

3.3. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME DUHET TË VENDOSIN MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË SEANCAVE ME KOMISION TË GJYKATËSVE.

Rregullat duhet të qartësojnë nëse i gjithë ose një pjesë e komisionit të gjykatësve duhet të jenë fizikisht prezent në të njëjtën dhomë gjatë seancave dëgjimore hibride ose online, dhe a u lejohet atyre të diskutojnë online. Duhet të sigurohet komunikim i besueshëm ndërmjet gjykatësve të kolegjit në vende të ndryshme.

4. TEKNOLOGJI TË REJA TË KOMUNIKIMIT

4.1. DËGJIMET ONLINE DHE HIBRIDE DUHET TË JENË KOMPATIBILE ME STANDARDET ETË DREJTAVE TË NJERIUT DHE ME SUNDIMIN E LIGJIT.

Dëgjimet online ose hibride duhet të përdoren si një alternativë për seancat dëgjimore me prezencë fizike vetëm nëse këto të fundit nuk janë të sigurta ose të janë të pamundura. Seancat dëgjimore online ose hibride duhet të zhvillohen në përputhje me legjislacionin nacional dhe në përputhje me sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut, duke përfshirë rregullat që garantojnë sigurinë e të dhënave, privatësinë e komunikimit dhe pavarësinë e gjyqësorit. Rritja e numrit të seancave dëgjimore online ose hibride gjatë një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik mund të kërkojë përpilimin e ligjeve, udhëzimeve dhe protokolleve të veçanta nga hartuesit e rregullave në bashkëpunim me specialistët e IT-së, ekspertët e mbrojtjes së të dhënave dhe organet vetëqeverisëse gjyqësore. Këto rregulla duhet të shpërndahen ndërmjet gjykatësve dhe palëve të tjera të interesuara dhe të vihen në dispozicion për publikun.

4.2. DËGJIMET ONLINE OSE HIBRIDE NUK JANË TË PËRSHTATSHME NË TË GJITHA RASTET DHE DUHET TË LEJOHET FLEKSIBILITET.

Hartuesit e rregullave duhet të lejojnë liri veprimi kur vendosin nëse seancat dëgjimore online ose hibride janë të mundshme dhe të dëshirueshme, duke i dhënë përparësi dëgjimeve me prezencë fizike sa më shumë që të jetë e mundur. Kryetari i trupit gjykues duhet të merr parasysh implikimet e një vonese të mundshme në të drejtat e palëve, natyrën e seancës, a kanë qasje dhe në dispozicion pajisje të nevojshme, nevojën për të ekzaminuar fizikisht provat, si dhe dobësitë e palëve dhe dëshmitarëve. Kështu, seancat dëgjimore online ose hibride mund të mos jenë të mundshme në të gjitha rastet dhe duhet të përdoren vetëm nëse është e përshtatshme. Kryetari i trupit gjykues duhet të marrë parasysh mendimin e palëve dhe të dëshmitarëve që kanë të bëjnë me këtë dhe të miratojë vendim të arsyeshëm.

4.3. VENDOSJA E TEKNOLOGJIVE TË REJA DUHET TË SHOQËROHET ME PLANIFIKIM PËR VLERËSIME TË

PËRPUTHSHMËRISË ME KAPACITETET DHE TË DREJTAT E NJERIUT.

Hartuesit e rregullave duhet të kryejnë vlerësim të plotë të përputhshmërisë së të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit dhe vlerësimit teknik përpara se të vendosin teknologjitë e reja në sallën e gjyqit. Për shembull, aplikimi i teknologjive të reja nuk duhet të cenohet barazinë para ligjit; nuk duhet të bëhet një pengesë shtesë për realizimin e të drejtave procedurale të palëve. Rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të shpjegojnë se si duhet të organizohen seancat, çfarë softuerësh dhe pajisjesh kërkohen, si mund të organizohet komunikimi i pambikëqyruar i palëve me avokatët e tyre, çfarë duhet të bëjë kryetari i trupit gjykues me dëshmitarët që shkaktojnë probleme ose pjesëmarrësit e tjerë në gjyq, çfarë duhet bërë në rast të lidhjes së keqe të internetit, nëse një pjesëmarrës nuk mund të dëgjohet dhe në situata të tjera të ngjashme.

4.4. ORGANET E VETËQEVERISJES SË GJYQËSORIT DUHET TË MUNDËSOJNË TRAJNIME TË MJAFTUESHME PËR TË GJITHË PJESËMARRËSIT E DËGJIMEVE ONLINE DHE HIBRIDE.

Gjykatësit, kuadri i gjykatës dhe pjesëmarrësit e tjerë profesionistë të seancave dëgjimore online dhe hibride duhet të pajisen me trajnim të mjaftueshëm në zgjidhjet e IT-së, si dhe mbrojtjen e të dhënave dhe standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut gjatë seancave dëgjimore online ose hibride. Palëve, të pandehurve, dëshmitarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë *ad hoc* duhet t'u jepen udhëzime se si të operojnë softuerin dhe harduerin. Rekomandohet që para seancës të organizohet një takim online ndërmjet pjesëmarrësve në dëgjim dhe personit përgjegjës për mbështetjen teknike. Ky person duhet të konfirmojë se pjesëmarrësit janë në gjendje të përdorin softuerin dhe harduerin dhe të marrin pjesë në seancë.

4.5. MUND TË NEVOJITET NJË SISTEM PËR MENAXHIM ONLINE TË RASTEVE DHE DOKUMENTEVE PËR SEANCAT ONLINE OSE HIBRIDE E FEFKTIVE.

Hartuesit e rregullave duhet të prezantojnë sisteme

elektronike të menaxhimit të rasteve që lidhin të gjithë palët e interesuara për të lehtësuar distancimin social para, gjatë dhe pas seancave dëgjimore. Për të lehtësuar seancat dëgjimore online ose hibride, hartuesit e rregullave mund të kenë nevojë të sigurojnë vendosjen e rregullave të reja të thjeshtuara që kanë të bëjnë me qarkullimin e dokumenteve. Këto rregulla nuk duhet të rrezikojnë vërtetësinë e këtyre dokumenteve. Pranimi i kopjeve të skanuara të dokumenteve dhe nënshkrimeve elektronike mund të jetë i përshtatshëm në disa raste. Sistemet online të menaxhimit të rasteve dhe dokumenteve nuk duhet të ndërhyjnë në pavarësinë e gjyqësorit dhe të drejtat e privatësisë së pjesëmarrësve; për shembull, qasja në materialet gjyqësore duhet të mbrohet në mënyrën e duhur.

4.6. GJITHMONË DUHET TË SIGUROHET KOMUNIKIMI I BESUESHËM MIDIS PALËVE DHE AVOKATËVE TË TYRE.

Rekomandohet që hartuesit e rregullave dhe organet vetëqeverisëse gjyqësore të sigurojnë komunikim të besueshëm ndërmjet palëve (të pandehurit në çështjet penale ose palët në çështjet civile) dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë përpara dhe gjatë seancave dëgjimore online dhe hibride. Nëse është e mundur, një komunikim i tillë duhet të bëhet me prezencë fizike ose përmes një kanali të sigurt dhe të besueshëm. Ky rekomandim është veçanërisht i rëndësishëm nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim.

4.7. HARTUESIT E RREGULLAVE DHE GJYKATËSIT KRYESUES DUHET TË SIGUROJNË QË PJESËMARRËSIT E DËGJIMEVE ONLINE OSE HIBRIDE TË MUND TË MARRIN PJESË PA PRESION, SHQETËSIM APO FRIKË.

Është më sfiduese të sigurohet që pjesëmarrësit të mos jenë nën presion gjatë seancave dëgjimore online ose hibride sesa gjatë seancave dëgjimore me prezencë fizike. Për shembull, viktimat e dhunës në familje nuk duhet të japin dëshmi nga shtëpia në prani të të akuzuarit. Ata që ankohen për keqtrajtim nuk duhet të japin deklaratat e tyre në stacion policor. Për aq sa është e mundur dhe e nevojshme, pjesëmarrësit e seancave dëgjimore online ose hibride duhet të jenë në gjendje të shohin të gjithë pjesëmarrësit e tjerë.

4.8. RREGULLAT E EMERGJENCËS DUHET TË SQAROJNË EFEKTET JURIDIKE NË DËGJIMET HIBRIDE DHE ONLINE NGA DËSHTIMI I SISTEMIT TË TEKNOLOGJISË INFORMATIKE.

Rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të përfshijnë zgjidhje në rast të një dështimi të sistemit IT. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur dështime të tilla mund të rezultojnë me ndërhyrje në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të drejtat procedurale të palëve.

4.9. MBËSHTETJA TEKNIKE DHE PAJISJET E CILËSISË SË LARTË DUHET T'JU MUNDËSOHEN TË GJITHË PJESËMARRËSVE NË GJYKIM QË TË SIGUROHET ANGAZHIMI I TYRE EFETIV NË PROCES.

Gjykatësit, palët, kuadri i gjykatës dhe të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të gjykimit duhet të kenë mundësi të kenë qasje në IT mbështetje për të shmangur vonesat dhe vështirësitë teknike gjatë seancave dëgjimore online ose hibride. Cilësia e lidhjeve të internetit dhe video kamerave (përfshirë fotografimin dhe zërin) të përdorura në seancat hibride ose online duhet të jetë e përshtatshme që mos të ndërhyjë në gjykim.

4.10. NËSE GJENDJA E JASHTËZAKONSHME VAZHDON PËR NJË PERIUDHË MË TË GJATË KOHORE, REKOMANDOHET QË TË ZHVILLOHET NJË SOFTUER I POSAÇËM PËR LEHTËSIMIN E DËGJIMEVE ONLINE OSE HIBRIDE.

Mjetet gjenerike të video konferencave janë të përshtatshme si një zgjidhje e përkohshme gjatë një gjendje të jashtëzakonshme shëndetit publik, por kërkohen më shumë mjete të personalizuar në planin afatgjatë. Hartuesit e rregullave duhet gjithashtu të sigurojnë që gjykatat, qendrat e paraburgimit dhe institucionet e tjera përkatëse të drejtësisë penale të kenë pajisje dhe softuer të përshtatshëm për të lehtësuar seancat dëgjimore online ose hibride. Kjo pajisje do të siguronte gatishmërinë e gjyqësorit nacional për gjendjet e jashtëzakonshme të ardhshme të shëndetit publik.

5. VEPRAT PENALE LIDHUR ME GJENDJET E JASHTËZAKONSHME DHE DËNIMET GJATË GJENDJEVE NË SHËNDETIN PUBLIK

5.1. GJATË GJENDJEVE TËJASHTËZAKONSHME SHËNDETIT PUBLIK, AUTORITETET DUHET QË VEPRAT PENALE TË REJA TË VENDOSURA QË JANË TË LIDHURA ME GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME T'I SHQYRTOJË VAZHDIMISHT DHE TË NJËJTAT T'I ANULOJË POSA TË MBAROJË GJENDJA E JASHTËZAKONSHME E SHËNDETIT PUBLIK.

Veprat penale të futura për zbatimin e masave që synojnë kufizimin e pasojave të gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik duhet të miratohen vetëm kur është tepër e nevojshme. Sapo të përfundojë gjendja e jashtëzakonshme, këto masa dhe veprat penale përkatëse duhet të hiqen. Gjatë kësaj është e mundshme lloje të reja të rasteve duke përfshirë ato në të cilat shqiptohen dënime për shkelje të rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme dhe këto raste nuk duhet të përbëjnë barrë të tepruar për gjyqësorin nacional.

5.2. VEPRAT PENALE LIDHUR ME GJENDJEN E JASHTËZAKONSHME DUHET TË PËRCAKTOHEN VETËM NËSE ATO JANË TEPËR TË NEVOJSHME DHE PROPORCIONALE MERËNDËSINË E GJENDJESSË JASHTËZAKONSHMENË SHËNDETIN PUBLIK.

Veprat penale të lidhura me gjendjet e jashtëzakonshme nuk duhet të ndjekin në mënyrë jo proporcionale të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit duhet të parashikojnë kontroll të rregullave të gjendjes së jashtëzakonshme aty ku është e mundshme. Masat për rregullimin e keq informatave që kanë të bëjnë me gjendjen e jashtëzakonshme në shëndetin publik duhet të hartohen me kujdes pasi ato mund të çojnë në censurimin e opinioneve jopopullore ose të pakicave. Dënimet penale për veprat e keqinformimit duhet të shmangen.

5.3. RREGULLAT PËR GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME QË VENDOSIN NDËSHKIME PËR MOSPËRPUTHJE DUHET TË JENË TË QARTA DHE TË SAKTA, DHE T'I

KUMTOHEN PUBLIKUT PARAPRAKISHT.

Rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme, veçanërisht ato që vendosin dënime, duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të shpallura paraprakisht para hyrjes së tyre në fuqi. Ligjet që vendosin këto sanksione duhet të jenë lirisht të qasshme, për shembull në faqet publike të internetit, dhe të reklamohen gjerësisht në mediat e zakonshme. Nëse rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme ndryshohen shpesh për të pasqyruar natyrën e paparashikueshme të gjendjeve të jashtëzakonshme në shëndetin publik, atëherë duhet të ekzistojë një sistem paralajmërimesh i cili do t'i paraprijë zbatimit të sanksioneve më serioze.

5.4. GJOBAT DUHET TË KORRESPONDOJNË ME SERIOZITETIN E VEPRËS SË KRYER.

Gjatë vlerësimit të shumës së dukur të gjobës, duhet t'i kushtohet vëmendje rrethanave individuale, duke përfshirë ndikimet specifike gjinore. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për njerëzit që nuk krijojnë të ardhura për shkak të masave emergjente.

5.5. DUHET TË SIGUROHET ZBATIM I VAZHDUESHËM I NDËSHKIMEVE.

Hartuesit e rregullave, në kuadër të kompetencave të tyre, duhet të sigurojnë zbatimin e vazhdueshëm të ligjeve të urgjencës në të gjithë shtetin përmes komunikimit efektiv midis agjencive të ndryshme të zbatimit të ligjit.

5.6. DUHET TË EKZISTOJ REVIZION GJYQËSOR LIDHUR ME GJOBAT DHE SANKSIONET TJERA TË CILAT I REALIZON POLICIA OSE AUTORITETET VENDORE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Edhe pse mund të vendosen disa procedura të thjeshtuara gjatë gjendjeve të jashtëzakonshme, veprimet administrative duhet të rishikohen nga autoritetet gjyqësore. Gjendja e jashtëzakonshme në shëndetin publik nuk mund të justifikoj mungesën e një

shqyrtimi gjyqësor efektiv dhe të shpejtë.

5.7. DËNIMI ME BURGIM ËSHTË MJET QË PËRDORET SI OPSION I FUNDIT.

Heqja e lirisë duhet të jetë e arsyeshme, e domosdoshme dhe proporcionale edhe gjatë gjendjes së emergjencës. Gjykatësit duhet të marrin në konsideratë ndikimin që dënimet me burg (veçanërisht ato të shkurtra) mund të kenë mbi të pandehurin në rrethanat e një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik. Dënimet me burg duhet të kufizohen dhe tu jepet përparësi metodave alternative, si gjoba apo arresti shtëpiak, duhet të kenë përparësi. Kur vlerësojnë përshtatshmërinë e ndalimit të dikujt, hartuesit e rregullave duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë implikimeve në shëndetin publik nga mbipopullimi në vendet e ndalimit dhe rreziqeve të veçanta për të paraburgosurit të shkaktuara nga gjendja e jashtëzakonshme në shëndetin publik.

6. PROCESI I PARABURGIMIT NË PROCEDURA PARA HETIMORE DHE PARABURGIMIT NË PRITJE TË GJYKIMIT SIPAS KËRKESËS

6.1. SECILI I ARRESTUAR DUHET TË PARAQITET PARA GJYKATËSIT.

I paraburgosuri ka të drejtë të sillet fizikisht para gjykatësit. Hartuesit e rregullave duhet të sigurojnë që kësaj të drejte t'i jepet përparësi. Nëse gjendja e jashtëzakonshme në shëndetin publik nuk lejon praninë fizike, duhet të organizohet një seancë dëgjimore online ose hibride duke përdorur një video kamerë me definicion të lartë. Një avokat mbrojtës preferohet të jetë i pranishëm në të njëjtin vend me të paraburgosurin gjatë seancës. Nëse prania fizike e një avokati pranë personit të ndaluar nuk është e mundur, duhet të ketë një linjë të besueshme komunikimi dhe të pa mbikëqyrur, për shembull qasja në dhoma të siguruara me një kanal komunikimi të sigurt ose nëpërmjet një video lidhjeje të veçantë, për tu mundësuar të paraburgosurve të kenë qasje efektive, të shpeshtë dhe të besueshme me avokatët e tyre.

6.2. EDREJTA PËRQASJETË BESUESHMETENJË AVOKAT DUHET TË GARANTOHET AQ SA ËSHTË E MUNDSHME GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHMENË SHËNDETIN PUBLIK.

Ata që janë në paraburgim duhet të kenë qasje te një avokat. Nëse është e nevojshme, ambientet e paraburgimit duhet të pajisen me video-konferenca të pambikëqyrura. Kufizimet e nevojshme mund të vendosen për të garantuar sigurinë e avokatëve dhe të paraburgosurve, por nuk duhet të cenojnë thelbin e të drejtës për të pasur një avokat. Kohëzgjatja e vizitave mund të jetë e kufizuar në kohë, por këto kufizime duhet të jenë proporcionale dhe të justifikuar, për shembull nga mungesa e objekteve dhe faktorëve të tjerë përkatës. Stacionet e policisë, burgjet dhe gjykatat duhet të pajisen me ambiente video-konferencash që funksionojnë siç duhet, të cilat mund t'u mundësojnë avokatëve të marrin pjesë në mënyrë efektive në seancat dëgjimore online ose hibride.

6.3. AUTORITETET LIGJ-ZBATUESE DUHET TË PËRDORIN MASËN E LIRIMIT ME KUSHT SA MË SHUMË TË JETË E MUNDSHME GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, institucionet nacionale gjyqësore duhet të marrin në konsideratë gjendjen e jashtëzakonshme në shëndetin publik dhe të përdorin forma alternative të kufizimeve si liri me kusht ose arresti shtëpiak në vend të paraburgimit..

7. MONITORIMI I GJYKIMIT DHE SEANCAVE DËGJIMORE PUBLIKE

7.1. SEANCAT GJYQËSORE DUHET TË JENË TË HAPURA PËR PUBLIKUN AQ SA ËSHTË E MUNDUR.

Rekomandohet që seancat dëgjimore online dhe hibride të bëhen publike aq sa është e mundur. Qasja e publikut në seancat dëgjimore mund të sigurohet duke lejuar publikun të marrë pjesë në seancën dëgjimore në kohë reale ose duke shkarkuar regjistrimet audio/video nga faqet e internetit të gjykatave. Gjykatat nacionale duhet të marrin në konsideratë privatësinë e pjesëmarrësve, prezumimin e pafajësisë, nevojën për të shmangur ndërprerjet e seancave, nëse çështja është me interes publik dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm kur vendosin nëse do të lejojnë publikun të kenë qasje në seancën dëgjimore online ose të ngarkojnë regjistrimet.

7.2. NDALIMI I PËRGJITHSHËM I SEANCAVE DËGJIMORE PUBLIKE GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK ZAKONISHTËSHTË JOPROPORCIONAL.

Një rregull i përgjithshëm që parandalon publikun e gjerë dhe monitoruesit e gjyqit të marrin pjesë në seancat dëgjimore online, hibride ose të rregullta zakonisht është masë disproporcionale dhe autoritetet duhet të gjejnë mënyra për të lejuar qasje të caktuar në seancat dëgjimore. Disa ndalime të përkohshme mund të jenë të pranueshme në faza të veçanta të një gjendjeje të jashtëzakonshme, por këto kufizime duhet të jenë të arsyeshme dhe më pas të hiqen gradualisht si ndryshojnë rrethanat. Të gjitha rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme duhet të jenë praktike, të arritshme dhe proporcionale.

7.3. ORGANET VETËQEVERISËSE GJYQËSORE DUHET TË HARTOJNË NJË STRATEGJI KOMUNIKIMI GJATË GJENDJEVE TË JASHTËZAKONSHME NË SHËNDETIN PUBLIK.

Në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme në shëndetin publik, kur monitorimi i gjykimeve mund të kufizohet, gjyqësori nacional duhet të komunikojë në mënyrë efektive me palët e interesuara dhe publikun e gjerë, për shembull duke bërë rregullisht njoftime për shtyp për raste të veçanta dhe duke informuar rreth

procedurave. Të ngarkuarit për komunikim me shtypin duhet të jenë në dispozicion për të dhënë informacion për rastet me rëndësi të madhe.

7.4. ORGANET VETËQEVERISËSE GJYQËSORE DUHET TË GJEJNË RRUGË ALTERNATIVE PËR TË MUNDËSUAR QASJE PËR MONITORUESIT E GJYKIMIT NË RASTET ME INTERES.

Nëse seancat duhet të zhvillohen me dyer të mbyllura për shkak të një gjendje të jashtëzakonshme në shëndetin publik, gjykatat mund të përdorin mjete të tjera për të mundësuar monitorim të gjyqimit në një masë të caktuar, për shembull duke siguruar qasje në disa dokumente gjyqësore dhe në video/audio regjistrime.

7.5. ORGANET E VETËQEVERISJES GJYQËSORE DUHET TË ZBATOJNË RREGULLA UNIFORME PËR TË MUNDËSUAR QASJEN E VËZHGUESVE GJITHANDEJ VENDIT.

Rregullat e zbatueshme që kanë të bëjnë me monitorimin e provave duhet të unifikohen në mbarë vendin, por me shmangie të vogla për shkak të kapacitetit të hapësirës, situatës shëndetësore dhe faktorëve të tjerë përkatës. Këto dallime duhet të merren parasysh nga rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme. Për shembull, rregullat e gjendjes së jashtëzakonshme mund të ofrojnë disa kufizime në numrin e monitoruesve dhe të pjesëmarrësve të tjerë të lejuar në sallën e gjyqit të një madhësie të caktuar.

7.6. QASJA NË GJYKIME DUHET TË JETË PRAKTIKE DHE EFEKTIVE, JO FORMALE DHE DEKLARATIVE.

Kur rregullat e emergjencës lejojnë qasje të shpejtë dhe të lehtë të monitoruesve në gjykime, një qasje e tillë nuk mund të kufizohet nga rregullat komplekse të pranimit që pengojnë në mënyrë efektive monitoruesit të marrin pjesë në seancat dëgjimore. Për shembull, një kohë e gjatë e pritjes për leje mund të pengojë një monitorues të ketë qasje në një gjykim me interes të veçantë. Kufizimet që kanë të bëjnë me shëndetin duhet të jenë të arsyeshme dhe të deklaruara në mënyrë eksplicite.

ANEKSI: LISTA E BURIMEVE

ANGAZHIME TË RËNDËSISHME TË OSBE-SË

Dokumenti i takimit të Kopenhagës i Konferencës mbi dimensionin njerëzor të KSBE-së (Dokumenti i Kopenhagës, 1990)

Karta e Parisit për një Evropë të Re (Paris, 1990)

Dokumenti i takimit të Moskës i Konferencës së tretë mbi dimensionin njerëzor të KSBE-së (Dokumenti i Moskës, 1991)

MATERIALE TË OSBE-SË

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), *Gjinia, diversiteti dhe drejtësia, Përmbledhje dhe rekomandime*, Maj 2019

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) *Angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor dhe reagimet e shtetit ndaj pandemisë Covid-19*, Korrik 2020

Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) *Funksionimi i gjykatave gjatë Pandemisë Covid-19: Udhëzues bazë*, Tetor 2020

MATERIALE NDËRKOMBËTARE

Këshilli Konsultativ i Gjykatësve Evropianë (CCJE) *“Deklarata e presidentit të CCJE për rolin e gjykatësve gjatë dhe pas pandemisë Covid-19: Mësime dhe Sfida”* 24 Qershor 2020

Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropianë (CCPE) *“Opinion Nr. 15 (2020 i CCPE): Roli i prokurorëve në situata të gjendjes së jashtëzakonshme veçanërisht kur përballet me Pandemi”* 19 Nëntor 2020

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve Çnjerëzore ose Degraduese (CPT) *Deklaratë e parimeve që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të privuar nga liria*, 20 Mars 2020

Deklaratë e parimeve që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të privuar nga liria, 20 Mars 2020

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), *“Lista kontrolluese për një protokoll mbi seancat virtuale dhe klauzolat e sugjeruara për protokollet kibernetike dhe urdhrat procedurale që kanë të bëjnë me organizimin e seancave virtuale”*, Prill 2020

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC) *“Shënim udhëzues i ICC-së mbi masat e mundshme që synojnë Zbutjen e Efekteve të Pandemisë”* 9 Prill 2020

Komisioni Ndër-Amerikan i të Drejtave të Njeriut (IACHR), *“Pandemia dhe të drejtat e njeriut në kontinentin amerikan”*, Rezoluta Nr. 1/2020, e miratuar më 10 Prill 2020.

Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (ICJ), *Parimet e Sirakuzës mbi dispozitat e kufizimit dhe shmangies në paktin ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike*, 1985

Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (ICJ), *“Udhëzuesi i ICJ –së për gjykatat dhe COVID-19”*, 5 Maj 2020

Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (ICJ), *“Video konferencat, gjykatat dhe rekomandimet për COVID-19 bazuar në standardet ndërkombëtare”*, Nëntor 2020

OHCHR, *“Gjendjet e jashtëzakonshme dhe COVID-19: Udhëzime”*, 27 Prill 2020

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, *Organi i parimeve për mbrojtjen e të gjithë personave nën çdo formë paraburgimi ose burgimi*, rezolutë/miratuar 9 Dhjetor 1988, A/RES/43/173

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *Grupi i punës për paraburgimin arbitrar, Parimet dhe udhëzimet themelore të Kombeve të Bashkuara për Mjetet juridike dhe procedurat për të drejtën e kujtudo të privuar nga liria për të çuar procedurat para një gjykate*, Korrik 2015

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, *“Deklarata e kryetarit – PRST 43/1. Implikimet e pandemisë COVID-19 në të*

Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, “Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit, juristëve dhe vlerësuesve, si dhe pavarësia e avokatëve”, Rezoluta 44/9 miratuar më 16 Korrik 2020

Komisioni i Venecias, Përmbledhje e opinioneve dhe raporteve të komisionit të Venecias mbi gjendjet e jashtëzakonshme, Prill 2020

Komisioni i Venecias, “Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për provat elektronike në procedurat civile dhe administrative, Janar 2019

Komisioni i Venecias, “Raport i përkohshëm mbi masat e marra në shtetet anëtare të BE-së si rezultat i krizës Covid-19 dhe ndikimi i tyre në demokraci, sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore”, Opinioni Nr. 995/2020, Tetor 2020

VENDIMET GJYQËSORE

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Içetkovina dhe të tjerët kundër Ruisë, Nr. 12584/05, 4 Korrik 2017

Karaçencev kundër Ruisë, Nr. 23229/11, 17 Prill 2018

Lebedev kundër Ruisë, Nr. 4493/04, 5 Tetor 2007

Marcello Viola kundër Italisë, Nr. 45106/04, GJEDNJ 2006-XI

Misjukeviç kundër Ruisë, Nr. 63053/09, 30 Prill 2015, paragrafi 31

Sahnovski kundër Ruisë [GC], Nr. 21272/03, 2 Nëntor 2010

Svinarenko dhe Slednjev kundër Ruisë [GC], Nr. 32541/08 dhe 43441/08, GJEDNJ 2014

Trepashkin kundër Ruisë (Nr. 2), Nr. 14248/05, 16 Dhjetor 2010

Jam kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 31295/11, 16 Janar 2020

Komiteti për të Drejtat e Njeriut

Komenti i Përgjithshëm Nr. 29 mbi Gjendjet e jashtëzakonshme (Neni 4): Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 2001

Komenti i Përgjithshëm Nr. 32 mbi Nenin 14: E drejta për barazi para gjykatave dhe tribunaleve dhe për një gjykim të drejtë, 2007

Komenti i Përgjithshëm Nr. 35 mbi Nenin 9 (Liria dhe siguria e një personi), 2014

BURIME AKADEMIK

Shejn Darsi, “Të Drejtat e Minoriteteve në Gjendjet e Emergjencës”, Revista Ndërkombëtare për të Drejtat e Minoriteteve dhe Grupeve vëll. 9, Nr.4, 2002, f. 345

Dejvid Dizenhaus, Kushtetuta e Ligjit: Ligjshmëria në Kohë Emergjence (Kembrixh: Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, 2006)

Kanstancin Xhehcijaru, “Shmangia nga Neni 15: a janë vërtet të nevojshme gjatë pandemisë COVID-19?” (2020) Rishikimi i Ligjit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 359

Kanstancin Xhehcijaru, “COVID-19 dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, 27 Mars 2020, Vëzhguesit e Strasburgut

Alan Grin, “Shmangiet nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në përgjigje të Pandemisë së virusit korona: Nëse jo Tani, Kur?”, Rishikimi i Ligjit Evropian për të Drejtat e Njeriut, vëll. 2020, Nr. 3, f. 262

Alan Grin, Autorizim urgjent në kohë pandemie (Bristol: Shtypi i Universitetit Bristol, 2020)

Alan Grin, Gjendjet e Përhershme të Emergjencave dhe Sundimi i Ligjit: Kushtetutat në Epokë Krize (Oksford: Botime Hart, 2018)

Tom Hikman QC, Ema Dikson dhe Rejçël Xhons, [Coronavirusi dhe liritë civile në Mbretërinë e Bashkuar](#), faqe interneti e Blackstone Chamber, 6 Prill 2020

Zbinek Loebl, [Krijimi i gjykatave Online: E Ardhmja e drejtësisë është e hapur për të gjithë](#) (Wolters Kluwer, 2019)

Jeremy McBride, [“Një analizë e përgjigjeve ndaj COVID-19 dhe Kërkesave të GJEDNJ”](#), [www.ECHRblog](#), 27 Mars 2020

Martin Shajnin, [Simpozium i COVID-19: Të kufizohet apo të mos kufizohet ?](#) [Opinio Juris Blog](#), 6 Prill 2020

Riçard Saskind, [Gjykatat Online dhe e Ardhmja e Drejtësisë](#) (Oxford: Shtypi i Universitetit Oxford, 2019)